



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr. 186/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit G. I., sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.273/17 të dt.14.2.2017, për shkak të veprës penale : të kanosjes nga neni 185 par 2 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit Gazmend Imeri , të dëmtuarës A. H , mbrojtësit të viktimave D. H dhe të prokurorit të shtetit Ardita Beqiraj me dt.25.5.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

AKTGJYKIM

Kundër të pandehurit :

I pandehuri G. I. i lindur me dt. 03.9.1983 në fsh. N. K e Gj, i biri i I dhe nënës Sh e gjinisë B, , i nacionalitet Rom, shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në liri.

Konform nenit 363 par.1 pika 1.1. të KPPRK

REFUZOHET AKTAKUZA

Gjëja se:

Me dt. 03.2.2017 rreth orës 16:30 , në fsh. Kerstovc Komuna e Pejës , me qëllim të frikësimit përmes telefonit seriozisht e kanos të dëmtuarën -ish bashkëshorten e tij A. H se do ti shkaktoj ndonjë të keqe , në atë mënyrë që e dëmtuara dhe i pandehuri kanë qenë në lidhje martesore , por nga dhuna e shumë si ajo fizike e po ashtu psikike që ia ka shkaktuar , i pandehuri të dëmtuarës , e dëmtuara merr vajzën e tyre të përbashkët dhe shkon për të jetuar tek prindërit e saj, ku i pandehuri që nga largimi i të dëmtuarës , vazhdimisht e shqetëson duke e thirr në telefon dhe duke e kanos , ku dhe ditën e lartcekur, i pandehuri e thërret në telefon të dëmtuarën dhe të njëjtës i drejtohet me fjalët kanosëse “ **nuk kam me ta lënë vendin hiq në Kosovë , hiq mos mujsha ma shumë kom me marr një copë të trupit tand kom me qu në Nivokaz**” si dhe “**le të ruhet baba jot**” me çka te e dëmtuara ka shkaktuar frikë dhe ankth se nëse të ardhëm do ti shkakton ndonjë të keqe, pasi që i pandehuri vazhdimisht i përdorë fjalët kanosëse.

-me çka kishte për të kryer veprë penale : të kanosjes nga neni 185 par 2 të KPRK-së

-sepse prokurori i shtetit hoqi dorë nga ndjekja penale kundër të pandehurit - pasi që paraprakisht e dëmtuara e tërhoqi propozimin për ndjekje .

Shpenzimet procedurale iu ngarkohen mjeteve buxhetore të gjykatës

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.14.2.2017 kundër të pandehurit G. I , ka ngritë aktakuzë PP. nr.273/17, për vepre penale : të kanosjes nga neni 185 par 2 të KPRK-së duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Para fillimit të shqyrtimit fillestar e dëmtuara A. H ka kërkuar fjalën dhe ka deklaruar:

Meqenëse vajza ime përkatësisht e jona D jeton me babanë këtu të pandehurin G unë ju deklaroj se nuk jam e interesuar që ta vazhdoj ndjekjen penal kundër të pandehurit .Këtë që po e them po e them lirshëm nga vullneti im dhe jo nga ndikimi i kujdoqoftë.

Mbrojtësi i viktimave D. H ka deklaruar :

Pasi që vepra penale e kanosjes nga par 1 dhe 2 ndiqet sipas propozimit të palës së dëmtuar dhe meqenëse pala e dëmtuar në shqyrtimin e sotshëm u deklarua se tërhiqet nga ndjekja e penale edhe unë si mbrojtës i viktimave e përkrah në tërësi propozimin e palës së dëmtuar.

Pastaj prokurori i shtetit ka deklaruar :

Pas tërheqjes së propozimit për ndjekje kundër G. I për vepër penale të kanosjes nga ana e të dëmtuarës A. H konform nenit 52 të KPPRK-së e lidhur me nenin 185 par 5 të KPK-së heqë dorë nga ndjekje penale kundër të pandehurit G. I për vepër penale të kanosjes nga neni 185 par 2 sepse në mungesë të propozimit nuk jam paditëse e autorizuar.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 363 par 1 pika 1.1. të KPPRK u vendos si në dispozitivin e aktgjykimit, përkatësisht kundër të pandehurit është refuzuar aktakuza .

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 25.5.2017.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi palët me të drejtë ankese
Mund të paraqesin ankesë në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .